

1. NDERHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë¹).

DATA	R/REPO njëjavore me çmim variabël	R/REPO mujore	R/REPO tremujore
06.01.2011	9,590.00		
13.01.2011	7,750.00		
20.01.2011	5,800.00		
27.01.2011	10,000.00		
03.02.2011	6,800.00		2,000.00
10.02.2011	4,800.00	2,000.00	
17.02.2011	13,100.00		
24.02.2011	12,330.00		
03.03.2011	6,500.00		2,000.00
10.03.2011	10,900.00		
17.03.2011	12,800.00		
24.03.2011	13,000.00		
31.03.2011	13,100.00		

1.1. Operacionet e tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektimin e likuiditetit.

Për injektimin e likuiditetit Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, *marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor*, mesatarisht 9.73 miliardë lekë¹ në javë si dhe instrumentet rregulluese me maturim më të gjatë se një javë. Ashtu si gjatë tremujorit të fundit të vitit 2010, *marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me maturim tremujor* u përdor në 2 raste në vlerë nominale 2.00 miliardë leke për ankand. *Marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me përdorim njëmuor* është përdorur vetëm në 1 rast, nga 4 raste në tremujorin e fundit të vitit 2010, në vlerë nominale 2.00 miliardë lekë.

1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse


Gjatë tremujorit të parë të vitit 2011, depozita njëditore u përdor në 19 raste, mesatarisht 0.15 miliardë lekë, gati 0.56 miliardë lekë më pak se tremujorin e kaluar; kur ky instrument është përdorur në 32 raste, mesatarisht 0.70 miliardë lekë. Përdorimi i depozitës njëditore u përqendrua kryesisht në ditët e para të vitit 2011 si dhe në ditët e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 6 raste, mesatarisht 0.17 miliardë lekë kundrejt 5 rasteve të tremujorit të kaluar me një mesatare 0.71 miliardë lekë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblodhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për vitin 2010.

¹ Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2010 dhe tremujorit të parë të vitit 2011 (me çmim blerjeje).



2. NDRËHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2011

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Banka e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në tregun e brendshëm valutor në tremujorin e parë të vitit aktual.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Blerjet nga Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe kanë qenë 13,196.75 milionë lekë, ndërsa shitjet 13,211.89 milionë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 45.76 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - IBRD).

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të parë të vitit 2011

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	13,196.75	13,211.89
TË TJERA (IDA, IBRD)	45.76	